



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Integritimit Evropian
Ministarstvo za Evropske Integracije - Ministry of European Integration

Prishtinë, 27 tetor 2016

THIRRJE E HAPUR

Përzgjedhja e përfaqësuesve të shoqërisë civile në grupin punues për Strategjinë e Komunikimit të procesit të integritimit Evropian

Ministria e Integritimit Evropian për ta hartuar Strategjinë e Komunikimit të procesit të integritimit Evropian, në zbatim të standardeve minimale për konsultim publik fton përfaqësuesit e shoqërisë civile të nominojnë anëtarë për të qenë pjesë e këtij grupi. Përfaqësuesit e shoqërisë civile në grupin punues për Strategjinë e Komunikimit të procesit të integritimit Evropian do të nominohen dhe zgjedhen nga vet organizatat e shoqërisë civile, ndërsa i gjithë procesi do të organizohet nga Platforma CiviKos në bashkëpunim me Ministrinë e Integritimit Evropian (MIE).

Nga shoqëria civile, si anëtarë të këshillit do të përzgjedhen 6-8 anëtarë, varësisht prej përfaqësimit dhe të sigurohen së paku nga një anëtarë për secilën nga fushat në vijim:

1. Procesi i Integritimit Evropian, liberalizimi i vizave dhe MSA në përgjithësi
2. Kriteret politike (demokracia dhe sundimi i ligjit, të drejtat e njeriut dhe të minoriteteve, bashkëpunimi rajonal dhe ndërkombëtar)
3. Kriteret ekonomike (stabiliteti makroekonomik, zhvillimi i sektorit financiar, funksionimi i ekonomisë së tregut, konkurrenca, etj.)
4. Standardet Evropiane (tregu i brendshëm, liria e lëvizjes, prokurimi publik, arsimi, bujqësia, ambienti, energjia, transporti, statistikat, etj.) si dhe
5. Në komunikimin e fushave të lartpërmendura.

Procesi i përzgjedhjes do të mundohet që të sigurojë balancin në mes të:

1. Përfaqësimi - duke u dhënë mundësinë OSHC-ve që të nominojnë kandidatë/e nga rradhët e tyre ose të OSHC-ve tjera sektoriale

2. Ekspertiza – duke përcaktuar kriteret bazë që duhet të plotësohen nga të nominuarit, si dhe nga OSHC-ve nominuese.

Kriteri kryesor për të nominuarit përcakton që: I nominuari duhet të ketë përvojë të dëshmuar pune në fushën e caktuar; dhe të jetë i angazhuar në një OSHC që për të paktën 1 vit të fundit është e profilizuar në sektorin e caktuar.

Kriteri kryesor i OSHCsë nominuese përcakton që: OSHC të ekzistojë të paktën për 3 vite; dhe e drejta për të nominuar një kandidat për fushën e caktuar të garantohet vetëm për OSHC-të që janë të profilizuara në atë sektor apo të kenë realizuar projekte të tilla në të kaluarë dhe të paraqesin dëshmi për to.

Nominimi

Për të përzgjedhur përfaqësuesit e shoqërisë civile në grupin punues për Strategjinë e Komunikimit të procesit të integritimit Evropian ftohen OSHC-të aktive në Kosovë për të nominuar përfaqësuesit e tyre. Ftesa nuk është e kufizuar vetëm te organizatat anëtare të Platformës CiviKos.

Për të nominuar një kandidat/e, OSHCja duhet të dorëzojë dokumentet e mëposhtme:

1. Një biografi të kandidatit/es të nominuar (CV me max. 2 faqe)
2. Letër motivimi (max. 1 faqe) si dëshmi për përvojën e tyre në OSHC, interesin e madh të tyre mbi çështjet e integritimit Evropian dhe se si ajo është e rëndësishme për grupin punues për Strategjinë e Komunikimit të procesit të integritimit Evropian
3. Certifikatën e regjistrimit të OJQsë

Dokumentet e kompletuara duhet të dorëzohen me email në info@civikos.net ose me postë në adresën *Platforma CiviKos, Rr. Bedri Pejani 7/a, 10000 Prishtinë*, jo më vonë se **31.10.2016**.

KRITERET BAZË PËR OSHC-TË TË CILAT BËJNË NOMINIME DHE KANDIDATËT E NOMINUAR

Kriteret bazë që duhet të plotësojnë OSHCtë të cilat bëjnë nominime dhe kandidatët e nominuar janë:

Kriteret për organizatat të cilat nominojnë kandidatë:

Të drejtë për të nominuar kandidatë kanë të gjitha OSHCtë e regjistruara sipas Ligjit për Liri të Asociimit në OJQ, të cilat:

1. Janë aktive të paktën që nga viti 2012;
2. Në veprimtarinë e tyre mbulojnë njërën nga fushat e lartpërmendura.

Kriteret për kandidatët e nominuar

Të nominuarit duhet të plotësojnë këto parakushte:

1. Të kenë përvojë të dëshmuar në fushën e caktuar për të paktën 3 vite
2. Të jenë të angazhuar në një organizatë të shoqërisë civile e cila për të paktën 1 vit të fundit është e angazhuar në njërën nga fushat e specifikuara

Kufizimet në procesin e nominimeve

1. Secila OSHC mund të nominojë ose të përkrahë nominimin e më së shumti një kandidat/e për një fushë të caktuar.
2. Secila OSHC mund të nominojë ose të përkrahë nominimin e një përfaqësuesi/e nga vetë ajo OSHC.
3. Asnjë OSHC nuk mund të nominojë ose të përkrahë nominimin e ndonjë kandidati/e jashtë fushës së veprimtarisë së OSHCsë.

Pas përfundimit të nominimit, paneli i përbërë nga Drejtori i zyrës për Komunikim dhe Informim në MIE dhe një përfaqësues i Sekretariatit të Platformës CiviKos do të verifikojë nëse kandidatët e nominuar i plotësojnë kriteret e kërkuara. Të gjithë kandidatët që konstatohet që i plotësojnë kriteret e kërkuara do të përfshihen në listën përfundimtare për votim.

Menjëherë pas përpilimit të listës përfundimtare për votim, Platforma CiviKos do të njoftojë publikisht për hapjen e procesit të votimit dhe do të publikojë në faqen e vet të internetit fletëvotimin zyrtar. Të gjitha OShCtë e regjistruara mund të votojnë për kandidatët e tyre të preferuar brenda një afati prej 3 ditësh nga hapja e procesit të votimit. Secila organizatë mund të votojë për 6 deri 8 kandidatë nga lista e kandidatëve të përfshirë në fletëvotim.

Votuesit mund të hedhin votën e tyre me e-mail, postë të rregullt ose personalisht në zyrën e CiviKos. Në rastin e votimit me e-mail ose me postë të rregullt, organizata që voton duhet të dërgojë fletëvotimin e plotësuar dhe kopjen e certifikatës së regjistrimit të OJQ-së. Në rastin e votimit në zyrën e CiviKos, organizatat duhet të dorëzojnë kopjen e certifikatës së regjistrimit të OJQ-së dhe të hedhin fletëvotimin e tyre në kutinë e votimit në zyrën e CiviKos. Votimi anonim mund të bëhet vetëm nëpërmjet votimit në zyrën e CiviKos.

Procesi i votimit do të organizohet dhe menaxhohet nga një komision i përbërë nga personeli i Sekretariatit të Platformës CiviKos, që caktohet nga Drejtori Ekzekutiv i CiviKos. Pas përfundimit të afatit për votim, komisioni i Sekretariatit të Platformës CiviKos do të numërojë fletëvotimet për të përcaktuar se cili(a) kandidat(e) ka marrë numrin më të madh të votave. 6-8 kandidatë që marrin më së shumti vota zgjedhen si përfaqësues të shoqërisë civile në grupin

punues për Strategjinë e Komunikimit të procesit të integrimit Evropian. Nëse dy kandidatë marrin numrin e barabartë të votave, vendi si përfaqësues të OShCve në grupin punues do të përcaktohet me short në mes tyre.

Për të mbikëqyrur procesin e numërimit të votave, Platforma CiviKos do të ftojë në cilësinë e vëzhguesëve të gjitha OShC-të që kanë bërë nominime, rrjetet aktive të shoqërisë civile, përfaqësuesit e Departamentit për Regjistrim të OJQ-ve dhe përfaqësuesit e MIE-së.

Për të reflektuar diversitetin shoqëror dhe të shoqërisë civile në Kosovë, inkurajohet nominimi i grave, anëtarëve të komuniteteve jo-shumicë dhe grupeve të nënpërfaqësuar.

Për çfarëdo pyetje rreth këtij procesi të përzgjedhjes, kontaktoni Platformën CiviKos nëpërmjet e-mailit info@civikos.net ose numrit të telefonit 038 224 904.

Mandati i përfaqësuesëve të shoqërisë civile

Përfaqësuesit e shoqërisë civile të përzgjedhur si anëtarë të grupit punues për hartimin e strategjisë për Komunikim e procesit të Integrimit Evropian zgjedhen në mandat kohorë deri në aprovimin e strategjisë në fjalë. Para këtij afati, mandati ndërpritet në rastet e mëposhtme:

1. Kur përfaqësuesi/ja i shoqërisë civile në grupin punues jep dorëheqje;
2. Kur përfaqësuesi/ja i shoqërisë civile në grupin punues largohet nga sektori i shoqërisë civile
3. Kur përfaqësuesi i shoqërisë civile mungon në më shumë se 3 takime
4. Kur të paktën 30 % të organizatave të cilat e kanë nominuar kërkojnë nga Kryesuesi i grupit punues që të nisë procedurën e shkarkimit, për shkak të neglizhencës apo mos-përfaqësimit të duhur të interesave të shoqërisë civile në punën e grupit punues.